Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**14.08.2023**	**25.08.2023**	**2023/0557**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.08.2023, OE "Albo Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0557, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Albo Group SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vlersimi rapid i shkollave - faza e pare" me nr. të prokurimit: "624-22-13949-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0557 i dt:09.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të nderuar

AK na nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së, nr.2023/0176, sepse ka cituar "arsyjen"

e njëtën si heren e kaluar që ne nuk podesojme referenca edhe pse për këtë shumë

kajrtë e ka cituar mendimi i eksperit po ashtu edhe vendimi i panelit shqyrtues.

Citojmë AK:

"Tenderi juaj është refuzuar:, Te Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori

Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate së paku prej 20,000.00 €uro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve, ju nuk keni realizuar projekte te ngjashme ne tre vitit e fundit."

ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Projekti " Vlerësimi rapid i shkollave " në Komunën e Suharekës nënkupton një hulumtim profesional të gjendjes aktuale në secilën shkollë duke përfshirë 13 Inpute ku disa prej tyre jane:

• nivelin e menaxhimit,

• resurset humane,

• administratën,

• infrastrukturën,

• vizionin ,

• raportet ndërkolegiale,

• aktivet profesionale,

• organet qeverisëse të shkollës, etj..

Vlerësimi rapid i shkollave realizohet përmes teknikave të hulumtimit të konfirmuara si më profesionalet siç janë:

Planifikim I vlerësimit, vlerësim i institucioneve duke mundësuar të realizohet përmes instrumenteve matëse të cilat përfshihen: pyetësorët, biseda direkte, intervista, incimi I objektit përmes mjetit fotografik, incizimi audio I seciles interviste etj.

Kontratat e "Albo Group" shpk që lidhen me projkete të ngjajshme janë:

1."Strategjia Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural " Komuna e Mitrovicës , në vlerë prej 7,980.00 €, në ketë kontratë për ta hartuar strategjinë janë kryer këto aktivitet:

- Desk Research (Hulumtimet në tavolinë);

- Intervistat fushore;

- Fokus Grupet;

- Hulumtime;

- Organizim të Eventeve.

2. "Analiza e Fizibilitetit për Parkun Industrial" komuna e Podujevës, në vlerë prej 8,999.00 €, në ketë kontratë për ta kryer fizibilitetin strategjinë janë kryer këto aktivitet:

• Elementet për vendndodhjen;

• Pozitën e zonës;

• Infrastrukturën e zonës;

• Planin investues;

• Administrimin e Zonës;

• Vlerësimin e ndikimit në mjedis nga ndërtimi dhe zhvillimin e Zonës Industriale;

• Përparësitë Ekonomike për krijimin dhe zhvillimin e Zonave Industriale;

• Hyrjet Financiare.

3. "Shërbimet e trajnimit për stafin e Universitetit", Universiteti "Ukshin Hoti", në vlerë prej 3,540.00 €, për realizimin e kësaj janë mbajtur trajnimet me modulet:

1. Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë

2. Legjislacioni dhe standardet etike e profesionale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për studentë/palë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, praktikat e mira ndërkombëtare.

Së bashku me aktivitetet:

- Organizimin sallës së trajnimit e përshtatshme për trajnim;

- Kontraktimin e trajnerit për mbajtjen e trajnimit;

- Sigurimin e pijeve dhe ushqimit për pjesëmarrësit e trajnimit;

- Përgatitjen dhe shtypjen materialeve e trajnimit (kopje e fortë dhe email);

- Organizimin e testimit në fund të trajnimit;

- Certifikata.

Kërkojmë nga OSHP që të nxjerr urdhëresë për nënshkrimin e kontratës me që një herë OSHP e ka kthyer lëndën ne rivlerësim dhe AK për qëllime të tyre tenton ta bëjë anulim dhe nuk e zbaton vendimin e OSHP nr.2023/0176, njëherë kërkojmë të zbatohet edhe neni 131- i LPP-së.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Ankesën tonë në mënyrë meritore dhe të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për urdhëresë të nënshkrimit të kontratës e OE "Albo Group" SH.P.K

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose	9.1 & 9.2	**Tehničke i profesionalne mogućnosti** **Kërkesa 1 - Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate së paku prej 20,000.00 €uro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 – Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e puneve të kryera.**

ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet,

dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

[2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]

Titulli i projektit: Vlerësimi rapid i shkollave në Komunën e Suharekës

Sektori arsimit në Komunën e Suharekës, sikurse edhe në të gjitha komunat tjera në Republikën e Kosovës është njëra ndër fushat më të rëndësishme . Volumi i punëve, pjesëmarrja në buxhetin komunal dhe sidomos ndikimi i madh që ka për shoqërinë, bëjnë që fusha e arsimit të jetë e një rëndësie të veçantë. Në Komunën e Suharekës funksionojnë 33 institucione edukativo - arsimore , në të cilat janë të përfshirë rreth
9 400 fëmijë - nxënës (niveli: 0. 1. 2. 3) . Gjithashtu, arsimi është sektori i cili ka më së shumti të punësuar në Komunën e Suharekës me rreth 977 të punësuar, duke shpenzaur afër 30% të buxhetit të Komunës së Suharekës. Duke u bazauar në rezultatet e statistikave të ndryshme zyrtare, Suhareka në përgjithësi vlerësohet me arritje të mira në fushën e arsimit, duke shënuar progres të vazhdueshëm, por që kërkon ende shumë angazhim e investime me qëllim që të arrihen objektivat e parapara që do ta bëjnë arsimin e Suharekës të jetë konkurues për nga cilësia në rajon e më gjërë.

Tanimë është bërë publike që qeverisja komunale është e përcktuar që arsimi të jetë njëri nga prioritet kryesore të qeverisjes.

Ky vlerësim i rapid është një mundësi për të mbledhur informacion përpara se të hartohet një ndërhyrje. Me qëllim që të arrihet realizimi i objektivit të përgjitshëm, për fazën e parë të projektit janë paraparë një numër i objektivave specifike:

Vlerësimi Rapid i Shkollave

Raporti individual për rezultatet e gjetura të secilit institucion

Vlerësimi përfundimtar/ Raporti final i projektit

Projekti " Vlerësimi rapid i shkollave " në Komunën e Suharekës nënkupton një hulumtim profesional të gjendjes aktuale në secilën shkollë duke përfshirë 13 Inpute ku disa prej tyre jane:

nivelin e menaxhimit,

resurset humane,

administratën,

infrastrukturën,

vizionin ,

raportet ndërkolegiale,

aktivet profesionale,

organet qeverisëse të shkollës, etj..

Vlerësimi rapid i shkollave realizohet përmes teknikave të hulumtimit të konfirmuara si më profesionalet siç janë:

Planifikim I vlerësimit, vlerësim i institucioneve duke mundësuar të realizohet përmes instrumenteve matëse të cilat përfshihen: pyetësorët,biseda direkte, intervista, incimi I objektit përmes mjetit fotografik, incizimi audio I seciles interviste etj.

Zbatimi profesional i këtyre teknikave do të na mundësoj që të kemi një skanim real të gjendjes në secilën prej shkollave të komunës son dhe rrjedhimisht do të shoqërohet me rekomandimet ekzakte se nga duhet lëvizur me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të shkollave dhe rritjes së cilësisë në arsim.

Gjatë implementimit të këtij projekti, do të hartoj dokumentin "Rangimi i shkollave të Komunës së Suharekës sipas performances", që do bënte Komunën e Suharekës nder te vetmet e do ta kishte një dokument të tillë të miratuar.

Përfundimi projektit se fazës së pare, varësisht gjetjeve do të hartohen raportet individiale për secilën shkollë dhe në fund të të hartohet edhe raporti përmbledhës me rekomandimet përkatëse.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Njoftimi mbi vendimin e AK)

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **Albo Group SH.P.K., Rr. "Hyzri Talla", 10000, Prishtinë** me adresë në **Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Vlersimi rapid i shkollave - faza e parë** me Numër të prokurimit: **624-22-13949-2-2-1** Numër i brendshëm: **624-22-134-221** kundër **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK** , të datës: **27.07.2023** të publikuar në ueb–faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **28.07.2023** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Pretendimi nr. 1

Sa i perket ketij pretendimi nuk qendron - Komisioni i Vleresimit me kujdes e ka analizuar ofertën tuaj dhe ju nuk keni ofruar projekte të ngjshme që e plotësojnë kiriterin e kërkesës për projekte të ngjashme, ku ju keni ofruar vetëm një projekt të llojit të ngjashëm që vlera e tij nuk e përmubush kriterin e nevojshëm prej 20,000.00 euro:

15	"Shërbimet e trajnimit për stafin e Universitetit"	31.08.2022	31.11.2022	3,540.00 €	Universiteti "Ukshin Hoti"	egzon.krezlu@uni-prizren.com	043-864-866

Është i vetimi projekt **"Shërbimet e trajnimit për stafin e Universitetit"** që i plotëson kriteret, por **nuk** e përmbush kriterin e vlerës prej **20,000.00 euro**, në bazë të kritereve të Dosjes së Tenderit.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK–së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP–së në pajtim me nenin 109 të LPP–së. Ankesa pranë OSHP–së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP nr.176/23.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Albo Group SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesore sipas ankesës nr,557/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka dëshmuar se plotëson kërkesën e dosjes për 20,000 projekte të ngjashme në tri vitet e fundit.

AK në arsyetim të eliminimit konstaton se nga gjitha kontratat e prezantuara OE ankues, i njëjti ka vetëm një kontratë të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, dhe atë kontrata në vlerë 3,540.00 me Universitetin Ukshin Hoti.

Sqarojmë se ky arsyetim i AK-së për eliminim të OE ankues është identik si në rastin e ankesës 176/23, në të cilin rast si eksperti shqyrtues ashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit 176/23 kanë konstatuar se AK-së ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7, 59, 60, 62 të LPP-së, dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes së tenderit, dhe vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim vlerësojmë se AK-KK Suharekë ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.176/23, pasi nuk ka dhënë asnjë arsyetim detaj lidhur me mos pranimin e shumicës së kontratave të OE ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin konkret NUK janë kërkuar projekte të njëjta, por janë kërkuar projekte të ngjashme, dhe qasja e AK-së duke eliminuar gjitha kontratat që nuk ndërlidhen me shkolla apo arsim pavarësisht përmbajtjes së tyre është e gabuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues në rastin konkret është se OE ankues plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për 20.000 projekte të ngjashme.

Vlen të ceket se mos respektimi i vendimeve të OSHP-së sipas rregullores për prokurim publik nr.001/2023 paraqet shkelje të rëndë të LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SUHAREKË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Albo Group SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA